



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 813 Prot.

Tiranë, më 07.06 2019

**VENDIM Nr. 131, datë 28.05.2019**

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 6, datë 28.05.2019, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "Ndërtimi i linjës së transmetimit 110 kV Nënstacioni Sallmone-Gjiri i Lalëzit dhe shtesë trakti 110 kV Nënstacioni Sallmone"*-subjekti OSTsh.a., realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "Ndërtimi i linjës së transmetimit 110 kV Nënstacioni Sallmone-Gjiri i Lalëzit dhe shtesë trakti 110 kV Nënstacioni Sallmone"*-subjekti OST, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.
2. Subjekti OST sh.a., duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "Ndërtimi i linjës së transmetimit 110 kV Nënstacioni Sallmone-Gjiri i Lalëzit dhe shtesë trakti 110 kV Nënstacioni Sallmone", si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. ASHA të realizojë dokumentimin stratigrafik të shtresave, gjatë gërmimit për realizimin e bazamentit të shtyllës 49, në sipërfaqen e të cilës gjatë vëzhgimit arkeologjik janë identifikuar gjetje sipërfaqësore arkeologjike.
4. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
ELVON MARGARITA  
MINISTËR



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)